




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 27.06.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.06.2014, pas shqyrtimit të propozimit të Nr. 254, të datës 16.06.2014, paraqitur nga Drejtoria për Financa, Buxhet dhe Pronë, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (c) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale për vitet 2015-2017, me kufijt e caktuar buxhetor të cekur si vijon:
 - 1.1 Për vitin 2015 buxheti i komunës është në shumë prej 7,847,006.00€;
 - 1.2 Për vitin 2016 buxheti i komunës është në shumë prej 7,959,378.00€;
 - 1.3 Për vitin 2017 buxheti i komunës është në shumë prej 7,948,435.00€.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale është në kompetencë të Drejtorisë për Financa, Buxhet dhe Pronë.
3. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë për FBP dhe Arkivës.


Kryesues i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 30.06.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.06.2014, pas shqyrtimit të propozimit të Nr. 389, të datës 20.06.2014, paraqitur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 17, shkronja (r), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (m), nenin 27, shkronjat (ç) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 6, nenin 7, paragrafi 1 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr. 83, të datës 14.06.2013 mori:

V E N D I M

1. Lejohen mjetet financiare në shumë prej 8125€, për Ansamblin e Këngëve dhe Valleve 'Zëri i Kosovës' nga Fushë-Kosova, me destinim për mbulimin e shpenzimeve për të marrë pjesë në Festivalin Ndërkombtarë në qytetin Inegol të Turqisë, nga data: 15-22 Gusht 2014.
2. Mjetet financiare nga pika një (1) e vendimit lejohen për mbulimin e shpenzimeve për:
 - 2.1 Transportin me autobus;
 - 2.2 Pagesa për marrjen e vizave;
 - 2.3 Ushqim dhe pije gjatë udhëtimit;
 - 2.4 Shpenzime tjera të nevojshme.
3. Sigurimi i mjeteve financiare nga buxheti i komunës, sipas pikës një (1) të vendimit dhe kryerja e procedurave tjera, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për Financa, Buxhet dhe Pronë, Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Zyrës së Prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë për FBP,
Drejtorisë për KRS, Zyrës së Prokurimit dhe Arkivës.**


**Kryesues i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 02.07.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.06.2014, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 435, të datës 24.06.2014, paraqitur nga Kryetari i Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 61, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 8, paragrafi 3 të 'Rregullores për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të administratës komunale' Nr. 136, të datës 01.10.2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet, propozimi për emërimin e z. Halil Qerimi, i lindur më datë 01.03.1959, në fshatin Torinë, me vendbanim në Fushë-Kosovë, me kualifikim Fakulteti Filozofik-Katedra - Gjuhë Ruse, nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalinjve të Kosovës, në pozitën e Nënkrjetarit të Komunës për Komunitete, në komunën e Fushë-Kosovës, për periudhën dyvjeçare, prej datës 26.06.2014 - 25.06.2016.
2. I emëruari, të drejtat dhe përgjegjësitë e tij, në pozitën e Nënkrjetarit të Komunës për Komunitete, fillon t'i ushtrojë nga dita e emërimit të tij nga Kuvendi i Komunës, konform dispozitave ligjore në fuqi.
3. Nënkrjetari i Komunës për Komunitete për punën e tij i përgjigjet Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës.
4. Kryerja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për Financa, Buxhet dhe Pronë, konform Udhëzimit Administrativ Nr. 16/2008 të Qeverisë së Kosovës.
5. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Nënkrjetarit të Komunës për Komunitete, Drejtorisë për FBP dhe Arkivës.

**Kryesues i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi**





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 02.07.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.06.2014, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 71, të datës 16.06.2014, paraqitur nga Drejtoria për Arsim, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 17, shkronja (h), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (ë), nenin 27, shkronjat (ç) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Lejohen mjetet financiare, në shumë prej 26,400.00€, për zbatimin e Planit të Veprimit për parandalimin e braktisjes së mësimi nga nxënësit dhe funksionalizimin e mësimi parashkollor dhe parafillor.
2. Sigurimi i mjeteve financiare nga buxheti i komunës, sipas pikës një (1) të vendimit dhe kryerja e procedurave tjera është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për Financa, Buxhet dhe Pronë dhe Drejtorisë për Arsim.
3. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë për FBP,
Drejtorisë për Arsim dhe Arkivës.**

**Kryesues i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi**

